

**DRAFT**

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT**  
**PËR RININË NË BASHKINË**  
**SHKODËR**



## PERMBAJTJA

<b>Shkurtime</b> .....	2
<b>Hyrja</b> .....	3
<b>Metodologjia</b> .....	6
<b>Profili i Bashkisë Shkodër</b> .....	8
<b>Plani i veprimit deklarata e vizionit</b> .....	17
1. <b>Edukimi Gjithëpërfshirës</b> .....	19
1.1 Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	21
2. <b>Punësimi Rinore</b> .....	27
2.1 Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	28
3. <b>Shëndeti dhe mbrojtja sociale</b> .....	35
3.1. Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	37
4. <b>Pjesëmarrja rinore</b> .....	41
4.1. Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	42
5. <b>Rekreacioni, veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive</b> .....	47
5.1. Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	48
6. <b>Të Rinjtë dhe Evropa</b> .....	54
6.1. Matrica e Veprimtarive dhe Output-ve per Programin .....	55

## Shkurtime

MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
KQZ	Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OJF	Organizata jo Fitimprurëse
QKF	Qendra Kulturore e Fëmijëve
DSHP	Drejtoria e Shëndetit Publik
IST	Infeksione Seksualisht të Transmetueshme
SHR	Shëndeti Riprodhues

## Hyrja

Shkodra është një ndër qendrat më të rëndësishme të jetës ekonomike, sociale dhe politike. Ky qytet ka një numër të lartë të studentëve, që vijnë nga vende dhe qytete të tjera për të kryer studimet universitare. Parë nga ky këndvështrim, Plani Lokal i Veprimit për Rininë 2019-2022 synon përparimin e të gjithë të rinjve dhe të rejave që jetojnë në Shkodër, në mënyrë që të përfshihen në jetën sociale, politike, ekonomike dhe vendimmarrëse. Ky plan synon t'i vendosë të rinjtë dhe të rejat në qendër të vëmendjes së punës dhe përpjekjeve të Bashkisë Shkodër përgjatë 3 viteve të ardhshme, duke i konsideruar ata një komponent të rëndësishëm në përparimin qytetar.

Prioritetet/aksionet e propozuara, bazuar në:

- Situatën aktuale të të rinjve në Shkodër;
- Problemet dhe sfidat me të cilat përballet Bashkia Shkodër për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe sociale;
- Mundësitë dhe vizionin e Bashkisë Shkodër, për përparimin e të rinjve si qytetarë; aktivë dhe pjesëmarrës në proceset e ndryshimit të njësive administrative.

Duke iu referuar numrit të të rinjve dhe nevojave që ata kanë, mund të themi se, deri më sot, ka munguar një strategji në nivel vendor dedikuar të rinjve dhe objektivave që u japin përparësi nevojave të tyre në arsim, shëndetësi, shërbime kulturore, sociale, rekreative etj.

Problematikat që raportojnë të rinjtë janë përmbledhur në 6 prioritete kryesore:

1. Edukimi gjithëpërfshirës dhe cilësor
2. Punësimi rinor
3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje
4. Kreativiteti dhe shprehjetë kulturore, artistike e sportive

5. Shëndeti dhe mbrojtja sociale e të rinjve

6. Të rinjtë shqiptarë dhe Evropa

Prioriteti 1 - Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës adreson mangësitë fizike dhe materiale, si edhe vështirësinë e aksesit në institucione edukuese, për shkak të aftësive, përkatësisë në një grup vulnerabël apo të marginalizuar etj. Ky prioritet përmbledh dhe adreson të gjitha nivelet e arsimit në territorin e Bashkisë së Shkodër. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe, njëkohësisht, duke parashtruar masa që mund të ndërmerren drejt zgjidhjes.

Prioriteti 2 - Punësimi rinor përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos angazhimet sezonale ose studentore), efektshmërinë e politikave që janë në fuqi për të nxitur punësimin rinor, si dhe të rinjtë si sipërmarrës. Ky prioritet adreson bashkëpunimin ndërmjet bizneseve, Bashkisë së Shkodrës, vetëpërfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta në organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare e më tej.

Prioriteti 3 - Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje merret drejtpërdrejt me përfaqësimin e të rinjve për të marrë pjesë në Këshillin Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë, me mundësitë dhe motivimet e të rinjve dhe të rejave për të marrë pjesë drejtpërdrejt në politikëbërje dhe vendimmarrje në Shkodër. Në këtë kontekst, për të arritur në konkretizimin e masave të sugjeruara, janë analizuar nisma të mëparshme dhe efektshmëria e tyre, si edhe janë marrë në konsideratë nisma ekzistuese.

Prioriteti 4 - Kreativiteti dhe shprehjet kulturore, artistike e sportive, përfshin dhe adreson kohën e lirë, nevojën për rekreacion dhe promovimin e të rinjve virtuozë dhe të talentuar. Masat janë orientuar drejt krijimit të hapësirave, aktiviteteve, programeve, mundësive kulturore, hapësirave për të ushtruar sportin, për të bërë art dhe aktivitete të tjera krijuese dhe argëtuese.

Prioriteti 5 - Shëndeti dhe mbrojtja sociale e të rinjve përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe lehtësirash që të rinjtë përfitojnë për shkak të grupmoshës në të cilën ata bëjnë pjesë. Realizimi i këtyre shërbimeve dhe përfitimi që do të kenë të rinjtë, do të sillte përmirësimin e gjendjes së tyre në qytet dhe, për rrjedhojë, mirëfunksionimin e tyre efektiv si qytetarë të kësaj bashkie.

Prioriteti 6 - Të rinjtë shqiptarë dhe Evropa synohet të arrihet progres në rritjen e dimensionit evropian të të menduarit e të vepruarit të të rinjve në kuadër të aspiratës së anëtarësimit e integritit evropian, nëpërmjet nxitjes e mbështetjes së pjesëmarrjes dhe vullnetarizmit.

## Metodologjia

Gjatë hartimit të Planit të Veprimit është ndjekur procesi i shqyrtimit që nga faza e analizave, në përcaktimin e strategjisë dhe më pas në pasqyrimin e objektivave për çdo fushë në një matrice e cila përbën dhe dokumentin kryesor të këtij Plani.

Procedura e ndjekur për hartimin e Planit të Veprimit për rininë ka qenë e ndarë në disa faza:

Faza e parë: Studim mbi Problematikat e të rinjve në qytetin e Shkodrës.

Qëllimi i studimit ishte njohja e situatës në Bashkinë Shkodër në lidhje me shkallën e njohjes dhe aplikimit të legjislacionit kombëtar për politikën rinore dhe prioritetet lokale për të ardhmen në këtë drejtim.

Studimi përmban rezultatet e analizës së gjendjes në qytetin e Shkodrës, të diskutimeve në fokus grupe, të intervistave gjysmë të strukturuar, tryezave të rumbullakëta si dhe rekomandimet dhe hapat që duhen marrë në të ardhmen për të siguruar pjesëmarrjen rinore, të drejtat e të rinjve dhe rritjen e përfaqësimit të të rinjve në nivel lokal. Në studim gjithsej morën pjesë 668 të rinj. Përgatitja e studimit u krye duke u bazuar në indikacionet e strategjisë evropiane e asaj kombëtare, duke ruajtur, padyshim, këndvështrimin lokal në analizën e gjendjes dhe përcaktimin e problematikave rinore. Kësisoj edhe përcaktimi i rekomandimeve dhe i hapave që duhen ndërmarrë bazohet në respektimin e të tre dimensioneve të sipërpërmendura. Për këtë arsye, rezultatet u grupuan në këto drejtime kryesore:

1. Edukimi gjithëpërfshirës dhe cilësor
2. Punësimi rinor
3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrj
4. Kreativiteti dhe shprehjet kulturore, artistike e sportive
5. Shëndeti dhe mbrojtja sociale e të rinjve
6. Të rinjtë shqiptarë dhe Evropa

Faza e Dytë: Ngritja e grupit të punës me përfaqësues nga Bashkia dhe të rinj.

Grupi i punës kishte në përbërje të tij përfaqësues të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore, të rinj nga strukturat përfaqësuese rinore. Anëtarët u ndanë në 6 grupe pune ku secili grup në varësi të profesioneve dhe fushës së ekspertizës përkatëse ka mbledhur të dhëna ekzistuese në territor për të përfshirë në matricën e planit të veprimit. Grupet e punës kanë zhvilluar takime periodike ku diskutonin dhe jepnin kontributin e tyre me informacione për secilën tematikë të matricës së Planit të Veprimit për Rininë në nivel lokal. Treguesit e shfaqur nga takimet mundësuan përcaktimin e disa linjave mbi të cilat të orientohesh në mënyrë prioritare planifikimi dhe plotësimi i matricave dhe

Faza e tretë: Procesi i programimit me pjesëmarrje.

Përgjatë takimeve/trajnimeve morën pjesëmarrësit kanë qenë nga institucione të ndryshme lokale, puna e të cilëve prek edhe të rinjtë dhe interesat e tyre, duke përmendur: Bashkinë Shkodër, Qarkun Shkodër, Zyrën e Punësimit, Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Parlamenti rinore Shkodër, qendrat rinore, studentë etj. Qëllimi i zhvillimit të takimeve ka qenë mbledhja dhe ndarja e informacioneve kryesisht mbi Planin e Veprimit për të Rinjtë në nivel lokal. Pjesa hyrëse e këtyre takimeve ka qenë e bazuar në informacione të përgjithshme dhe orientuese mbi temën e përzgjedhur, më pas të rinjtë kanë zhvilluar në mënyrë të drejtpërdrejtë matricat e Planit të Veprimit në nivel lokal. Matrica përmban: Programin; Output-i; Përshkrimi i Output-it; Veprimtaria; Përgjegjësit; Afati kohor. Secili nga grupet punoi mbi objektivat e përcaktuara nga stafi i Shoqatës “Intelektualet e Rinj, Shprese”, të mbledhura këto nga studimi dhe analizat specifike për çdo tematikë.

Rezultati i programimit me pjesëmarrje mundësoi kështu përcaktimin e prioritetëve sektoriale për Bashkinë e Shkodrës, të aprovuara si nga administrata publike ashtu edhe nga aktorët më të angazhuar në territor. Gjatë takimeve, u diskutuan dhe analizuan çështjet kryesore që kanë të bëjnë me politikat rinore të Bashkisë Shkodër dhe u përcaktuan treguesit strategjikë të cilat duhen marrë parasysh gjatë zbatimit të Planit të Veprimit për Rininë.

Faza e katërt: Prgatitja e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Rininë dhe konsultimi me grupet e interesit. Në këtë fazë janë zhvilluar 3 takime të përbashkëta me Bashkinë Shkodër, Qarkun Shkodër, Zyrën e Punësimit, Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e Shëndetit Publik, Parlamenti rinore Shkodër, qendrat rinore, student, në të cilat është prezantuar drafti final që më pas do të dorëzohet Bashkisë Shkodër, për ta vendosur në axhendën e saj, të dokumenteve strategjike që do të miratojë në vijim të punës

## **PROFILI I BASHKISË SHKODËR**

### **KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE**


Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km<sup>2</sup>, i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.

Bashkia e Shkodrës përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë).

Qyteti i Shkodrës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës, i cili me nje sipërfaqe prej 368 km<sup>2</sup> është liqeni më i madh në Ballkan. Nga ky liqen buron Lumi Buna (44 km), i cili derdhet në detin Adriatik dhe rrjedha e poshtme e te cilit ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Buna bashkohet me lumin Drin rreth 2 km në jugperëndim të qytetit.

Nga ana lindore qyteti kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut dhe është 43 km i gjatë. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore. Pjesa kryesore fushore e qytetit sot ka një shtrirje prej 1,150 ha, ndërsa pjesa kodrinore ka një shtrirje prej 350 ha.





*Fig 1. Hartë Gjeografike, Bashkia Shkodër*

## QEVERISJA VENDORE

Gjendja aktuale e qeverisjes vendore është produkt i dinamikës së një sërë reformash institucionale për decentralizimin dhe autonominë vendore. Procesi i decentralizimit dhe i autonomisë vendore u materializua edhe më tej me miratimin e Kushtetutës dhe nënshkrimin e Kartës Europiane për Autonominë Lokale. Qeveria vendore në Shqipëri ngrihet dhe funksionon mbi bazën e parimit të autonomisë vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet. Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, ndërsa Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore. Me miratimin e ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-

territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ndarja e re territoriale përcakton si njësi të qeverisjes vendore 61 bashki dhe 12 qarqe. Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra. Në çdo bashki krijohet organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv. Organi ekzekutiv i bashkisë është kryetari i bashkisë. Organi përfaqësues i bashkisë është këshilli bashkiak. Ky organ përbëhet nga 51 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore.

## FUNKSIONET E QEVERISJES VENDORE

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione, kompetenca, si dhe funksione të deleguara. Rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Ndër funksionet bazë të njësive të vetëqeverisjes vendore janë:

1. Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
2. Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale.
3. Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
4. Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
5. Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.
6. Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.
7. Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike.
8. Funksionet dhe kompetencat e deleguara.

## FINANCAT

Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore. Në fondet e transferuara nga qeverisja qendrore përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e reja që i transferohen Bashkisë, transfertat e kushtëzuar dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

## DEMOGRAFIA

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njësitë administrative, njësitë me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,923 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

## PROFILI EKONOMIK

E pozicionuar në qendër të ndërlidhjes së bashkive Malësi e Madhe, Vau Dejës, Pukë, Lezhë dhe në qendër të ndërlidhjes ndërkufitare me bregdetin e Malit të Zi, liqenin e Shkodrës dhe në aksin e dy kryeqyteteve Tiranë dhe Podgoricë, Shkodra luan dhe do të luajë gjithmonë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të sistemit ekonomik, logjistik, arsimor, social e kulturor për të gjithë rajonin dhe komunitetin e Veriut, madje shtrirë dhe përtej kufirit.

Pas vitit ‘90 qeveria shqiptare ndërmori një sërë reformash dhe miratoi një sërë ligjesh që mbulonin pronësinë private, aktivitetin privat, falimentimin, investimet e huaja, mbrojtjen e konsumatorit, privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), dhe shumë elemente të tjerë të përfshirë në tregtinë moderne. Ekonomia e saj ndryshoi nga një ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë. Si rezultat i këtyre reformave, ndryshime të mëdha ndodhën në strukturën ekonomike të Bashkisë Shkodër. Shkodra dhe rajoni i Veriut me të gjithë tërësinë e vlerave dhe resurseve natyrore dhe ekonomike, kontribuon në mënyrë thelbësore, direkt dhe indirekt në vlerat e përgjithshme ekonomike dhe sociale kombëtare, si në ekonomi, tregëti, bujqësi, në

promovimin e imazhit ndërkombëtar të vlerave me të mira natyrore, kulturore dhe atyre shpirtërore. Shkodra me resurset dhe vlerat e saj kontribuon në GDP kombëtare nëpërmjet sistemit hidrik në prodhimin e energjisë elektrike, në prodhimin mineral, si dhe kontributin e saj nga të ardhurat doganore dhe tatimore etj.

Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh. Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në ekonominë vendore.

Industria përpunuese përbën një nga potencialet më të mëdha të zhvillimit në Shkodër.

Prania e zonës industriale në Shkodër, në të cilën janë përqëndruar biznese të mëdha përpunuese është një tjetër element me rëndësi në zhvillimin ekonomik, duke ofruar punësim dhe të ardhura për popullsinë.

## PROFILI I EDUKIMIT

### **Sistemin arsimor parauniversitar**

Nivelet e arsimit parauniversitar

- ❖ Arsimi parashkollor
- ❖ Arsimi bazë
- ❖ Arsimi fillor
- ❖ Arsimi i mesëm i ulët
- ❖ Arsimi i mesëm i lartë
- ❖ Gjimnazi

- ❖ Arsimi i mesëm profesional dhe arsimi imesëm i orientuar

### ***Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë***

Në Bashkinë Shkodër zhvillojnë aktivitetin e tyre arsimor 66 kopshte nga të cilat 59 publike (24 kopshte në Njësinë Administrative të Shkodrës dhe 35 në dhjetë njësitë e tjera administrative)

dhe 7 private. Përsa i përket arsimit fillor zhvillojnë aktivitetin e tyre 24 shkolla nga të cilat 23 janë publike dhe një është private. Sistemi i arsimit 9-vjeçar përbëhet nga 74 shkolla nga të cilat 62 publike (20 në Njësinë Administrative Shkodër, dhe 42 në dhjetë njësitë e tjera administrative) si dhe 12 shkolla 9-vjeçare private.

### ***Arsimi i mesëm, gjimnazet***

Në Bashkinë e Shkodrës zhvillojnë aktivitetin e tyre 22 gjimnaze nga të cilat 5 gjimnaze i gjejmë në Njësinë Administrative Shkodër dhe 8 gjimnaze në njësitë e tjera Administrative, si dhe 9 gjimnaze private.

### ***Arsimi i mesëm profesional dhe arsimi i orientuar***

Në Shkodër zhvillojnë veprimtarinë e tyre 6 shkolla profesionale, të cilat janë: Teknike Industriale “Arben Broci”, e Ndërtimit “Kolë Idromeno”, Artistike “Preng Jakova”, Gjimnazi Gjuhësor “Shejnaze Juka”, Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Teknologjike “Hamdi Bushati” dhe shkolla private Austriake Teknologji-Informacioni “Peter Mahringer”. Formimi që të rinjtë marrin në këto shkolla, është i fushave dhe specialiteteve të ndryshme, si mekanikë, automekanikë, shërbime mjetesh transporti, elektroteknikë, teknologji informacioni dhe komunikimi, teknikë kompjuterash, elektrikist, teknik hidraulik-ventilues, specialistë pyjesh, veterinerë, teknikë në fusha të ndryshme të ndërtimit, agjentë turizmi, ekonomistë.

### ***Universiteti Shkodër "Luigj Gurakuqi"***

Universiteti i Shkodrës u hap si Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës (ILP) në vitin 1957, duke qenë e para shkollë e lartë në vend pas asaj të Tiranës. Në vitin 1991 Instituti i Lartë Pedagogjik ngrihet në rangun e Universitetit. Sot Universiteti i Shkodrës përbëhet nga gjashtë fakultete:

*Fakulteti i Shkencave Shoqërore me katër departamente:* Departamenti i Gjuhësisë, Departamenti I Letërsisë, Departamenti i Historisë, Departamenti i Gjeografisë.

*Fakulteti i Shkencave të Natyrës me pesë departamente:* Departamenti i Matematikës, Departamenti I Informatikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Biologji – Kimisë, Departamenti i Infermierisë.

*Fakulteti i Shkencave të Edukimit me katër departamente:* Departamenti i Punës Sociale, Departamenti i Mësuesisë, Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve, Departamenti i Arteve.

*Fakulteti Ekonomik me tre departamente:* Departamenti i Administrim – Biznesit, Departamenti i Financë – Kontabilitet, Departamenti i Turizmit.

*Fakulteti i Drejtësisë me tre departamente:* Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.

*Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me tre departamente:* Departamenti i Anglistikës, Departamenti i Gjermanistikës, Departamenti i Romanistikës.

## PROFILI I FORCËS SË PUNËS

Fuqi punëtore nënkupton pjesën e shoqërisë e cila është e aftë për punë. Marrëdhëniet e punës ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit janë të rregulluara nga kontrata pune, në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”. Problemi i papunësisë është një çështje globale, analiza e saj është kryesore për të trajtuar vështirësitë aktuale dhe parashikuar ndryshimet në të ardhmen. Popullsia ekonomikisht aktive (forca e punës) përcaktohet si shumë e numrit të personave të punësuar me numrin e personave të papunë.

Punësimi: Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 rezulton se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 26,980 persona, nga të cilat 7,576 punonjës janë të punësuar në sektorin publik dhe 19,404 punonjës në sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve është në qytetin Shkodër, ndjekur nga Njësia Administrative Rrethina. Ndërsa njësitë administrative me numrin më të ulët të punësimit janë Postriba, Pulti, Shalë dhe Shosh. Megjithatë vlerësimi real i numrit të punësuarve në vend vështirësohet për shkak të mosdeklarimit nga personat që ushtrojnë veprimtari ekonomike jobujqësore/bujqësore, por që nuk figurojnë të regjistruar. Prandaj

mendohet se ky numër punësimi është edhe më i lartë. Një dukuri e tillë është e lidhur me lëvizjet migruese e cila ka sjellë një ulje të numrit të popullsisë në zonat rurale krahasuar me periudhën e fillim viteve '90, duke çuar në krijimin e qendrave urbane me dendësi populsië deri në 230.18 banorë/km<sup>2</sup> (Bashkia Shkodër) dhe zona më pak tërheqëse për banim me dendësi prej 4.4 banorë/ km<sup>2</sup> (Shalë, Shosh, Pult). Kjo reflekton edhe përqendrimin ekonomik drejt qytetit Shkodër. Ndërveprim të dendur me qytetin e Shkodrës rezultojnë të kenë njësitë Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi etj.

Struktura e punësimit sipas sektorëve:

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës gjatë viteve 2017 - 2018:

- 28 % e punëtorëve janë të punësuar në sektorin publik;
- 72% e punëtorëve janë të punësuar në sektorin privat.

Papunësia

Bazuar në të dhënat paraprake të marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për gjashtëmuajorin e parë të vitin 2018 rezulton se:

Emërtimi	Gjendja	në fund	të muajit	Sipas	grup	moshave						Sipas	nivelit	arsimor			
	Gjithsej	Femra	K/familjar	deri 19vjeç	20-24 vjeç	25-29 vjeç	30-34 vjeç	35-39 vjeç	40-44 vjeç	45-50 vjeç	mbi 50vjeç	më pak se fillor	fillor	9 vjeçar	mesëm I përgj	mesëm prof	universitar
Punëkërkuës të papunë gjithsej	4,648	2,249	2,140	178	393	258	242	295	492	813	1,977	59	226	2,439	1,055	596	273

Fig 2. Të Dhëna të punësimit, sipas grupmoshave, Drejtoria Rajonale e Punësimit, viti 2018

Për Bashkinë Shkodër numri i të papunëve 19-64 vjeç vlerësohet të jetë 4648 persona. Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave, shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë punë 19-39 vjeç është 29%, ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës mbi 40 vjeç është më e lartë. Kjo ka lidhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për moshë relativisht të reja.

Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave për vitin 2018.

Sipas nivelit arsimor. Për efekt klasifikimi vitet e arsimit të papunësisë janë ndarë në: më pak se fillor, fillor, 9- vjeçar, i mesëm i përgjithshëm, i mesëm profesional dhe universitar. Struktura e papunësisë sipas nivelit arsimor të të papunëve të regjistruar tregon se përqindjen më të lartë e zënë punëkërkuarit me arsimin 9-vjeçar, pasuar nga punëkërkuarit me arsim të mesëm. Po të analizojmë të papunët me arsim të mesëm, shkalla e papunësisë është më e ulët për personat me arsim të mesëm profesional krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme të përgjithshme. Të dhënat gjithashtu tregojnë se paga e të punësuarve rritet me rritjen e nivelit arsimor.

Sipas gjinisë. Për Bashkinë Shkodër, situata paraqitet si mëposhtë:

Për periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2018 rezultojnë të regjistruara si punëkërkuese të papuna 2,249 femra ose 48% e totalit të të papunëve të regjistruara.



## **PLANI I VEPRIMIT DEKLARATA E VIZIONIT**

**Vizioni strategjik i kësaj iniciative është të fuqizojë sektorin rinor nëpërmjet ngritjes së një mekanizmi efektiv dhe transparent që mundëson pjesëmarrjen e të rinjve jo vetëm në fazën konsultative e përgatitore të politikave rinore ne Bashkinë Shkodër, por gjithashtu në implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e planit lokal të veprimit për rininë, ne nivel lokal nëpërmjet bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër.**

Për këtë qëllim ne bashkëpunim me institucionet vendore dhe rajonale është përgatitur ky dokument strategjik qe kërkon te identifikojë ndërhyrjen ne sektorin e te rinjve sipas një plani te propozuar nga vete te rinjtë.

### **Plani Lokal i Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër 2019-2022:**

#### **Objektivat e përgjithshëm:**

- **Te ofroje mundësi te barabarta për edukim, punësim dhe mirëqenie për te rinjtë ne Bashkinë Shkodër.**
- **Te ofroje mundësi për te promovuar pjesëmarrjen qytetare aktive dhe fuqizimin social të të rinjve.**

**Plani propozon iniciativa ne gjashte fushat e mëposhtme:**

- 1. Edukimi gjithëpërfshirës**
- 2. Punësimi rinor**
- 3. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrje**
- 4. Rekreacioni, veprimtaritë kulturore, artistike e sportive**
- 5. Shëndeti dhe mbrojtja sociale e të rinjve**
- 6. Të rinjtë shqiptarë dhe Evropa**

Realizimi i këtij Plani zhvillohet ne disa linja veprimi:

- Bashkia Shkodër harton një plan veprimi tre vjeçar, ne baze te Planit Kombëtar për Rininë.
- Çdo vit ne baze te fondeve nga pushteti lokal, qeveria, donatore te ndryshëm dhe organizata lokale aprovohet fondi për planin e veprimit.
- Çdo tre vjet behet monitorimi ne nivel lokal i realizimit te planit te veprimit dhe komponentëve te tij.
- Publikimi i raportit te monitorimit.

## 1. EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS

**Qëllimi** për këtë sektor është përmirësimi i infrastrukturës arsimore, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve mbështetëse në funksion të përfshirjes së të gjithë fëmijëve në sistemin e detyruar arsimor.

Gjithashtu ky plan kërkon të ofrojë mundësi të barabarta për një edukim sa më cilësor duke promovuar arsimin profesional në përputhje me nevojat e tregut rajonal dhe lokal.

### **Objektivat:**

- Të pajisë të gjitha shkollat me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.
- Të mundësojë qasjen në sistemin arsimor në gjithë shtrirjen territoriale të Bashkisë Shkodër duke u dhënë përparësi zonave rurale dhe shtresave në vështirësi.
- Fuqizimi i strukturave që mbështesin edukimin profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Të inkurajojë edukimin formal dhe të mësuarit jo-formal në mbështetje të inovacionit (risisë), kreativitetit dhe sipërmarrjes së të rinjve.
- Njohje, implementim dhe funksionim të ligjit 69/2012 të pjesëmarrjes të të rinjve në bordet e shkollave/senateve.
- Të ofrojë mekanizma për ndërtimin e një dialogu konstruktiv mes stafit akademik dhe studenteve /nxënësve/ prindërve/komunitetit.
- Rritja e informimit publik për të ulur fenomenin e korrupsionit në sistemin arsimor.

## Rekomandimet

- Kryerja e investimeve nëpërmjet një studimi të hollësishëm dhe teknik mbi zhvillimin dhe ndërtimin e objekteve arsimore ekzistuese/të reja kryesisht në zonat informale dhe rurale ku nevojat janë më të mëdha.
- Pajisja e të gjitha institucionet shkollore me sistem të informacionit elektronik, biblioteka, laboratorë shkencorë e laboratorë profesionalë dhe gjithë hapësirën e kërkuar nga standardet bashkëkohore në arsim.
- Përmirësimi i kushteve të shkollave në arsimin e mesëm profesional duke ngritur një bazë të plotë prodhuese pranë këtyre shkollave, përmirësimin e gjendjes së konvikteve, si dhe forcimin e lidhjeve të shkollave profesionale me biznesin lokal me qëllim realizimin e praktikave mësimore të nxënësve pranë tyre.
- Një sistem arsimor transparent përmes digjitalizimit të shërbimeve arsimore dhe publikimit online të të dhënave.
- Të rinjve duhet t'u jepen më shumë mundësi dhe hapësira për kryerjen e stazheve të punës dhe edukimit jo-formal duke i filluar ato që në shkollat e mesme.
- Të implementohen të gjitha detyrimet për garantimin e kryerjes së rolit aktiv të përfaqësuesve lokalë në organet vendimmarrëse arsimore.
- Të zhvillojë struktura me pjesëmarrje në edukim si dhe bashkëpunime ndërmjet shkollave, familjeve dhe komuniteteve lokale.
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave të shoqërisë civile dhe komunitetit në monitorimin e cilësisë së arsimit.

## 1.1 PLANI LOKAL I VEPRIMIT PER RININE 2019-2022/ MATRICA E VEPRIMTARIVE DHE OUTPUT-VE PER PROGRAM

PROGRAMI	OUTPUT-I	PERSHKRIMI I OUTPUT-IT	VEPRIMTARIA	PERGJEGJES	AFATI KOHOR
Edukimi gjithë përfshirës dhe cilësor					
	<b>1. Paisja e të gjitha shkollave me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</b>	Mbulimi i territorit të Bashkisë Shkodër me institucione shkollore bashkëkohore me bazën materiale, me kushte sanitare dhe komode.	- Realizimi i një studim mbi nevojat për përmirësimin e infrastrukturës në institucionet arsimore - Investime për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstrukcion të shkollave egzistuese.	Bashkia Shkodër MASR DAR Donatorë	2019- 2022
		Institucioni arsimor t'u ofroje nxënësve mjedise dhe pajisje për veprimtari sportive, kulturore, zbavitëse edhe pas orëve mësimore, si dhe në ditët e pushimit.	- Ngritje e laboratorëve, bibliotekave, palestrave, bazave prodhuese të domosdoshme në cdo shkollë. - Të realizohen aktivitete që mbështesin dhe nxisin talentete e reja në fushën e artit dhe kulturës duke përdorur shkollën si vendi bazë për aftësimin e tyre. - Bashkia Shkodër dhe DAR të hartojnë programe të përbashkëta për aktivitete kulturore artistike dhe argëtuese në mbështetje të të	Bashkia Shkodër MASR DAR  Qendra Rinore Atelie, Drejtoritë e shkollave Bashkia Shkodër DAR  DAR Bashkia Shkodër Donatorë.	2019-2022

			rinjve.		
		Të mbështesë nxënësit e talentuar si dhe nxënësit pjesë e grupeve vulnerabël.	<p>- Të rritet numri i nxënësve që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike dhe që mbështen me ndihmë financiare nga ana e Bashkisë.</p> <p>- Ulja e mëtejshme e braktisjes së shkollës, në mënyrë të veçantë nga fëmijët romë përmes masave të ndryshme ndihmuese e stimuluese si tekstet dhe transporti falas, shtrirja e modelit të shkollave me drekë.</p> <p>- Bashkepunim midis shtëpive botuese dhe institucioneve arsimore për dhënien e librave me kosto të ulët.</p>	<p>Këshillat e njëjësive vendore</p> <p>Këshillat e mësuesve</p> <p>Bashkia Shkodër</p> <p>Këshilli bashkiak</p> <p>DAR</p> <p>MASR</p> <p>Bashkia Shkodër</p> <p>Keshilli bashkiak</p> <p>DAR</p> <p>MASR</p>	2019-2022
		Shkolla pa barriera për të rinjtë me aftësi të kufizuara fizike	Krijimi i infrastrukturës së duhur nëpër shkolla, për të rinjtë në vështirësi duke iu dhënë kështu të drejtën si gjithë bashkëmoshatarët e tyre për arsimim si dhe në qasjen ndaj shanseve dhe mundësive të barabarta për të avancuar në jetën që duhet të ketë çdo e re dhe i ri.	Bashkia Shkodër Keshilli bashkiak DAR MASR Donatorë	2019-2022

		Cilësia e lartë në procesin e mësimdhënjes me bazë materiale të domosdoshme për realizimin e metodave sa më efikase.	- Paisje e shkollave me bazën materiale të nevojshme për të rritur cilësinë e mësimdhënies - Një sistem arsimor transparent përmes digjitalizimit të shërbimeve arsimore dhe publikimit online të të dhënave.	Bashkia MASR DAR Donatorë	2019-2022
	<b>2. Të inkurajojë edukimin formal dhe të mësuarit jo-formal në mbështetje të inovacionit, kreativitetit dhe sipërmarrjes së të rinjve si dhe të fuqizojë strukturat që mbështesin edukimin profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.</b>	Ngritja e kurseve të reja profesionale sipas kërkesave të tregut do të sillte përgjigje më të madhe të nevojave të tregut dhe do të përputhte më shumë kërkesën me ofertën.	- Ngritja e kurseve të reja profesionale dhe trajnimi i të rinjve. - Të rinjve duhet t'u jepen më shumë mundësi dhe hapësira për kryerjen e stazheve të punës dhe edukimit jo-formal duke i filluar ato që në shkollat e mesme.	DAR, Bashkia Shkodër Qendra e formimit profesional. OJF;	
		Përmirësimi i bazës materiale në qendrat e trajnimit dhe kushteve të mësimdhënies dhe praktikave.	- Përmirësimi i kushteve të shkollave në arsimin e mesëm profesional duke ngritur një bazë të plotë prodhuese pranë këtyre shkollave, përmirësimin e gjendjes së konvikteve, si dhe forcimin e lidhjeve të shkollave profesionale me biznesin lokal me qëllim realizimin e praktikave mësimore të nxënësve pranë tyre.	DAR, Qendra e formimit profesional, Bashkia Shkodër, Dhoma e Tregëtisë Donatorët.	2019-2022

			- Përmirësimi i bazës materiale në qendrat e trajnimit.		
		Hartimi i kurikulave të veçanta për kurse profesionale, duke u krijuar më tepër lehtësira të rinjve.	Hartimi i kurikulave për kurset profesionale.	Qendra rinore; DAR, Qendra e formimit profesional.	2019-2022
		Trajnimi i stafit pedagogjik do të ndikonte në rritjen e cilësisë së formimit në këto qendra.	Trajnimi i stafi të qendrave të formimit profesional	DAR Qendra e formimit profesional, Bizneset, Universitetet.	2019-2022
		Hapja e kurseve artizanale për të ruajtur traditën.	Hapja e kurseve artizanale për të ruajtur traditën.	Qendra e formimit profesional. OJF-të,	2019-2022
		Identifi kimi i nevojave në zonat rurale për kurse trajnimi dhe zhvillimi i kurseve në përputhje me këto nevoja.	- Studim për identifikimin e nevojave. - Hartimi dhe zhvillimi i kurseve pranë zonave rurale në përputhje me nevojat.	Qendra Rinore dhe OJF-të që veprojnë ne Bashkinë Shkodër.	2019-2022
		Ndergjegjësimi i rinisë, nxitja dhe ndërgjegjësimi i punëdhënësve.	Fushata edukimi dhe sensibilizimi	Qendra Rinore DAR, Zyra e Punës Qendra e formimit profesional.	2019-2022
	<b>3. Njohje, implementim dhe funksionim të ligjit</b>	Fushata edukimi dhe sensibilizimi mbi njohjen	- Takime - Seminare informuese,	Qendra Rinore DAR,	2019-2022



	<b>69/2012 të pjesëmarrjes të të rinjve në bordet e shkollave/senateve, ofrimi i mekanizmave për ndërtimin e një dialogu konstruktiv mes stafit akademik dhe studenteve /nxënësve/ prindërve /komunitetit.</b>	dhe funksionimin e ligjit 69/2012 mbi çështjet e pjesëmarrjes së të rinjve në bordet e shkollave / senateve.	- Shpërndarje informacioni, - Ëëbsite	Bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak	
		Pjesëmarrja e të rinjve në borde, këshilla dhe komisione të shkollave do të rritet.	Këshillime/takime nëpërmjet të cilave do të sigurohet pjesëmarrja rinore dhe do të reduktohen pengesat teknike.	DAR Senatet e shkollave Bordi drejtues Qendra Rinore Këshilli Bashkiak	2019-2022
		Të implementohen të gjitha detyrimet për garantimin e kryerjes së rolit aktiv të përfaqësuesve lokalë në organet vendimmarrëse arsimore.			2019-2022
		Të zhvillojë struktura me pjesëmarrës në edukim si dhe bashkëpunime ndërmjet shkollave, familjeve dhe komunitetit lokal.			2019-2022

	<p><b>4. Rritja e informimit publik për të ulur fenomenit e korrupsionit në sistemin arsimor.</b></p>	<p>Identifikimi i fenomenit të korrupsionit që gjeneron probleme të shumta të llojit: mitmarrja, ushtrimi i presionit psikologjik nga ana e stafit pedagogjik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave të shoqërisë civile dhe komunitetit në monitorimin e cilësisë së arsimit.</li> <li>- Ngritja e ekipeve për evidentimin e denoncimeve dhe ndërgjegjësimin e të rinjve, prindërve, për të publikuar rastin.</li> <li>- Krijimi i zyrave të informacionit në cdo shkollë në bashkëpunim me DAR Shkodër dhe median e pavarur në funksionimin e saj</li> <li>- Krijimi i zyrave të ankesave me personel të pavarur nga drejtoria e shkollës.</li> </ul>	<p>MASR DAR Shoqëria Civile Bordet drejtuese të shkollave Media vizive dhe e shkruar</p>	<p>2019-2022</p>
		<p>Rritja e nivelit të informimit midis të rinjve dhe komunitetit në lidhje me përmasat reale të korrupsionit dhe praktikave korruptive, të mënyrave për t'i shmangur e luftuar këto praktika.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fushata sensibilizuese kundër korrupsionit.</li> <li>- Performanca, kompeticione, aksione në rrugë etj</li> <li>- Shpërndarje materialesh ndërgjegjësuere.</li> <li>- Takime publike dhe seanca dëgjimore.</li> <li>- Mbeshtetje të mediave lokale</li> </ul>	<p>DAR Bashkia e Shkodrës Bordet drejtuese në shkolla Shoqëria Civile Media</p>	<p>2019-2022</p>

## 2. PUNËSIMI RINOR

**Qëllimi:** Të mbështesë integrimin e të rinjve në tregun e punës, nëpërmjet punësimit ose sipërmarrjes, për të ulur nivelin e papunësisë duke lehtësuar tranzicionin nga shkollimi në gjetjen e punës në nivel lokal.

### **Objektivat:**

- Të sigurohet qasje e barabartë e të rinjve në tregun e punës.
- Të reduktohet diskriminimi i të rinjve në tregun e punës nëpërmjet rritjes së informacionit rreth mundësive të punësimit dhe kuadrit ligjor.
- Të ndërmerren programe trajnimi dhe të krijohen kushte të përshtatshme për të nxitur sipërmarrjen rinore.
- Ndërthurja dhe njohja e edukimit formal dhe joformal për t'i bërë sa më të përgatitur të rinjtë për tregun e punës.
- Të krijohen plane afat-shkurtër për të nxitur integrimin e të rinjve në tregun e punës, si dhe të merren masa strukturore duke u konsultuar me vetë të rinjtë.
- Ngritja e zyra të nxitjes së punësimit dhe orientimit rinor ku të punësohen edhe vete të rinjtë.
- Të ngrihen programe intershipi dhe të promovohen stazhet rinore.
- Të promovohet punësimi dhe përfshirja sociale e grupeve të ndryshme të rrezikuara.

### **Rekomandime**

- Të rriten përpjekjet e përbashkëta të të gjitha agjencive të punësimit, kompanive të biznesit, organizatave dhe institucioneve në nivel lokal për punësimin sa më efikas të të rinjve.
- Bashkia të nxisë punësimin e të rinjve, përmes uljes së taksimit të bizneseve që punësojnë të rinjtë dhe favorizimit me kredi të buta të të rinjve që duan të hapin biznese të vogla dhe të mesme.

- Bashkia të ketë rolin e rregullatorit për hapjen e bizneseve rinore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
- Të realizohen panairë punësimi për të rinjtë në mënyrë periodike.
- Të zbatohet me efikasitet programi i këshillimit për punë dhe profesion, duke përfshirë këtu programe të këshillimit në shkolla, universitete dhe në Zyrën e Punësimit.
- Të krijohet një sistem modern dhe i unifikuar i shërbimeve të punësimit në të gjithë Qarkun.
- Të kryhen fushata informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e të rinjve në punë dhe të punëdhënësve.
- Të inkurajohen të rinjtë me rezultate të larta duke u punësuar nga bashkitë/komunat përkatëse.

## 2.1. PLANI LOKAL I VEPRIMIT PER RININE 2019-2022/ MATRICA E VEPRIMTARIVE DHE OUTPUT-VE PER PROGRAM

PROGRAMI	OUTPUT-I	PERSHKRIMI I OUTPUT-IT	VEPRIMTARIA	PERGJEGJES	AFATI KOHOR
Punësimi rinor					
	<b>1. Të sigurohet akses i barabartë i të rinjve në tregun e punës dhe të reduktohet diskriminimi i të rinjve nëpërmjet rritjes së informacionit mbi mundësitë e</b>	Informimi i të rinjve për politikat fiskale.	- Takime, seminare informuese  - Fletpalosje dhe materiale informuese në pika kyce ku pjesëmartja e të rinjve është më e madhe.	Bashkia Shkodër DAR Dhoma e tregëtisë Zyra e Punës Qendra Rinore	2019-2022

	punësimi dhe kuadrit ligjor.				
		Njohja e Kodit të Punës nga të rinjtë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kryhen fushata informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e të rinjve në punë dhe të punëdhënësve.</li> <li>- Takime, seminare, emisione televizive informuese për njohjen e Kodit të Punës.</li> <li>- Publikime, materiale informuese.</li> </ul>	Bashkia Shkodër DAR Dhoma e tregëtisë Zyra e Punës Qendra Rinore Mediat lokale	2019-2022
		Fushatë sensibilizuese pranë bizneseve lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fushatë sensibilizuese pranë bizneseve lokale për promovimin e punësimi rinor.</li> <li>- Fletpalosje dhe materiale informuese.</li> </ul>	Dhoma e tregëtisë Zyra e Punës Bashkia Shkodër Qendra Rinore	2019-2022
		”Nxitja e punësimi të të rinjve në Shkodër”	Ulja e nivelit të papunësisë në nivel lokal duke zgjeruar mundësitë e punësimi për të rinjtë nëpërmjet trajnimit dhe informimit për tregun e punës.	Qendra Rinore AMSHC	2019
		Krijimi i lehtësirave fiskale për të gjithë ata sipërmarrës, biznese a kompani që duan të përfshijnë praktikant dhe të punësojnë të rinj në aktivitetin e tyre.	Bashkita të nxisë punësimin e të rinjve, përmes uljes së taksimit të bizneseve që përfshijnë praktikant dhe punësojnë të rinjtë.	Bashkia Shkodër Dhoma e tregëtisë Qendra Rinore	2019-2022

